

ZHVILLIMI I MITIT TË GJUHËS NË LETËRSINË SHQIPE TË SHEKUJVE XVI – XVII THE MYTH OF THE LANGUAGE IN THE ALBANIAN LITERATURE

ROVENA VATA & ERMIRA YMERAJ

Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike, Tiranë, SHQIPËRI

Email: rovena_vata@hotmail.com; ymeraje@hotmail.com

AKTET VI, 4: 461-468, 2013

PERMBLEDHJE

Në artikull nënvizohet interesimi dhe angazhimi e krijuesve të shekujve XVI – XVII në fusha të ndryshme të literaturës liturgjike, me çka përpiqen ta japin ndihmesën e tyre për zhvillimin e gjuhës shqipe. Janë katër autorët e parë të kulturës së shkruar në gjuhën shqipe. Është marrë në sheshim ndihmesa e Gjon Buzukut me Mesharin; e Pjetër Budit me Doktrinën, Pasqyrën e Ritualin; e Frang Bardhit me Fjalorin dhe e Pjetër Bogdanit me Çetën e profestëve. Lënda sheshohet kronologjikisht. Theksi kryesor vihet mbi angazhimin e secilit për ta plotësuar njëri – tjetrin dhe përpjekja e përbashkët për ta krijuar hartën e gjuhës së shkruar shqipe në këtë kohë.

Fjalët kyçe: miti i origjinës, miti i Skënderbeut, kod identifikimi, gjuhë e gjallë, leksiku, përkthimi, fjalë të reja.

SUMMARY

It is observed during this study that apart from the literature well-known myths such as: origin's myth, Skanderbeg's myth, Albanian language myth, great age's myth, the myth in itself has developed in different Albanian literature's periods, where it is clearly observed that these writers had developed this myth more due to the historical circumstances that the entire literature system and further passed through. The Albanian language myth is the most long life myth in the history of our national literature. All the old writers claim that they returned, translated, created and recreated their works in Albanian language. a variety of myths is present in the Albanian literature among which the most important can be mentioned Skanderbeg's myth, the great age's myth and the origin's myth. A considerable place is filled in the Albanian literature by the language's myth, which is found quite at all the authors of Albanian literature as a symbol of root searching and as a testimony of linguistic authenticity of a people. The myth is a fantastic description of the model of creation of the word. As such mythology studies the naïve description of the nature's phenomena and the foreseeing of the primitive man on the world and cosmos. The elaboration of the social issues in authors of old Albanian literature such as: blood feud, marriage, death and the elaboration of the blood concept at Buzuku and the kinship of Bardhi, through their creative work as well convey a moral order. The importance they had in the elaboration of folklore elements such as the disaster, death and curse at Budi, the fairies at Bodgani, and the devils at Buzuk or the prejudice and superstitions at Frang Bardhi. The presentation in their works of the great topics at Budi, the topic of regret, sin, punishment; Bogdani speaks about the sky, the soil, the sea, the fire. Bardhi left us another value with the work about Skanderbeg, his myth which can be found everywhere in any literature period.

Key words: origin's myth, Skanderbeg's myth, identification code, vivid language, lexicon, translation, new words.

Hyrje

Në letërsinë shqipe janë të pranishme një sërë mitesh, ndër të cilët më kryesorët mund të përmendim mitin e Shkënderbeut, mitin e motit të

madh, mitin e origjinës. Një vend të konsiderueshëm zë edhe miti i gjuhës. Atë e gjejmë pothuajse të gjithë autorët e kulturës së shkruar në gjuhën shqipe si simbol i kërkimit të

rrënjëve dhe si dëshmi e autenticitetit gjuhësor të një kombi, për dashurinë ndaj gjuhës, ruajtjes së saj nga ndikimet e jashtme dhe që, është më kryesorja si njëri prej mjeteve themelore të identitetit kombëtar.

Miti është përshkrim fantastik i modelit të krijimit të botës. Kështu edhe mitologjia studion përshkrimin naiv të fenomeneve të natyrës dhe parashikimin e njeriut primitiv mbi botën dhe kozmosin (Neziri 2010: 144). Identiteti i çdo kombi nis me gjuhën, që zhvillohet si kod komunikimi mes njerëzve të një hapësire të përbashkët gjuhësore, gjeografike, historike, zakonore, sociale-kulturore e psikologjike. Miti i gjuhës shqipe është miti më jetëgjatë në historinë e letërsisë kombëtare. Të gjithë shkrimtarët e vjetër thonë se i kthyen, përkthyen, krijuan e rikrijuan veprat e tyre në gjuhën shqipe. Sa herë bie fjala për gjuhën dhe përkthimin, është i pashmangshëm imazhi i *Kullës së Babelit*, është i pashmangshëm miti zanafillor i gjuhës, e cila para se të përshtjellohej, në mbarë tokën ishte një gjuhë e vetme me fjalë të njëjta.

Në këtë kuptim ndër mëkatet e para për të cilin është ndëshkuar njeriu, *pas frutit të ndaluar, vrasjes së Abelit* dhe mosbindjes para *Përmybtjes së Madhe*, hyn dhe i katërti *Mëkati i madhështisë*, sipas të cilit breznitë e Noes u besatuan dhe vendosën: *“Të ngrehim për vete një qytet dhe një Kullë, maja e së cilës do të prekë qiellin”*. Por, kjo krekosje nuk i pëlqeu Kreatorit. Ai për tu bindur në këtë akt *“zbriti në tokë /.../ dhe tha: “Njëmend qenkan një popull dhe paskan vetëm një gjuhë”* (Tufa 2009: 5 – 6).

Ajo që mund të pranohet, në pajtim me mitin biblik të ndarjes së gjuhëve është se të nesërmen, babilonasit u gjendën në një terr mosmarrëveshjeje dhe moskuptimi me njëri-tjetrin dhe qysh të nesërmen e asaj dite, lindi nevoja e pashmangshme për të kuptuar gjuhët e shumta, deri një ditë më parë të panjohura, çka do të thotë lindi domosdoja e përkthimit, që, sipas Ricoeur – it (ky duke përsëritur sentencën e Steinerit) lindi si nevojë e kuptimit midis njerëzve. Budi në lidhje me mitin e *“Babelit”*, përdori fjalë që ai i përktheu si *“porta e hyjve”*, edhe si i

damun, pra demon, djall, edhe si *ngatërroj, përshtjelloj*.

Në këtë linjë kanë vepruar edhe autorët e letërsisë shqipe të shekujve XVI – XVII, në veprat e të cilëve përkthimi ka luajtur rol vendimtar dhe secili është përpjekur të japë ndihmesën e vet në fushën përkatëse. Trajtimi i çështjeve sociale të këta autorë marrin përmasa të shqetësimit e të protestës së prelatit të krishterë për gjendjen e mjetuar shoqërore, me të cilat sillen të dhëna të rëndësishme etnografike e të jetës së shqiptarëve në këtë kohë, si: gjakmarrja, lindja, martesat, vdekja nga Buzuku dhe perceptimi i fisit nga Bardhi. Shënimet që sjellin për gjëmën, vdekjen e mallkimit (Budi), zanat (Bogdani), demonët (Buzuku), ose paragjykimet dhe bestytnitë (Frang Bardhi) janaë argument i rëndësishëm për mbijetojetesën e këtyre elementeve folklorike ndër shqiptarë deri në kohën e tyre.

Parashtrimi në veprat e tyre të temave të mëdha të Budi tema e pendesës, mëkatit, ndëshkimit, Bogdani flet për qiellin, dheun, detin, zjarrin. Bardhi na ka lënë një tjetër vlerë me veprën e Skenderbeut, miti i tij i kudo gjendur në çdo periudhë letrare. Shqipen e bukur, gjuhën plot ngjyra dhe muzikalitetin tronditës, me tharm natyral letrar, Budi dhe të gjithë shkrimtarët e shek XVI-XVII e shkëputen prej *pelenave* të mjegullta duke e bërë mjet komunikimi të kishës, formë kumtuese të kulturës e të letërsisë.

A ishte gjuha vetëm kod identiteti kombëtar?

Historia ndërgjuhësore e ndërdialogetore e dallueshme në hapësirën shqipfolëse, krijonte për gjuhën e shkruar nga shkrimtarët e shekujve XVI – XVII idenë a autorësisë parake. Veprat Buzukut e Budit me shokë nuk janë gjë tjetër pos tekste fetare doktrinare të përkthyer nga italishtja ose latinishtja nga autorë të kohës së Kundërreformës.

Libri i Gjon Buzukut shënon fillimin e një tradite letrare në Shqipëri. Shkrimet që kemi para këtij autori, janë vetëm emra, glosa, formula uratah, lista fjalësh, copa biblike të vogla; të gjitha dokumente, të cilat nuk janë krejt pa rëndësi për historinë e gjuhës, porse shumë peshë nuk mund të çojnë. Midis tyre në një dokument të Ragusës

(Dubrovnikut) të vitit 1285 dhe ky, sikundër shënon Sufflay, është i pari lajm që jepet për gjuhën shqipe ku thuhet: *“audivi unam voçem çlamantem in monte in lingua albanesca”*: *“Ndjeva një zë që thërriste në mal në gjuhën shqipe”* (Elsie 2001:13; Neziri 1998: 37-38).

Në vitin 1308 një autor anonim, pas gjithë gjasash një ithtar frëng i urdhërit Domenikan, në përshkrimin që jep për vendet dhe popujt e Europës lindore, për gjuhën e shqiptarëve shkruan se: *“habent enim Albani prefati linguam distincam a latinis, grecis et sclauis ita quod in nullo se inteligunt cum aliis nationibus”* (Neziri 1998: 38).

Afërsisht po prej asaj kohe, në vitin 1332, prelati francez Gulielm Ade, arqipeshkv i Tivarit (në vitet 1324-1330), thotë për shqiptarët se: *“flisnin një gjuhë krejt të ndryshme nga latinët, porse në gjithë librat e tyre përdorin shkrimin latin”* (Shuteriqi 2006: 39, 46).

Edhe Arnold von Harfi, pak gjysmë shekulli para Buzukut, më 1497, thotë për shqiptarët se: *“Këta kanë një gjuhë më vete, e cila ndërkaq nuk mund të shkruhet, meqë nuk kanë një shkrim (një alfabet) të vetin në vendin e tyre”* (Shuteriqi 2006: 130).

Nga kjo del fakti tjetër i dukshëm që gjuha parabuzukjane e vendit në Shqipëri ka qenë vetëm një gjuhë formulash lutjesh e uratash, copash biblike më vete, pra shkrime liturgjike me përmasa të vogla të caktuara për përdorim të përditshëm.

Në studimin *“Pjetër Budi dhe gjuha e tij”* Eqrem Çabej arrinte në përfundimin se duke i kundruar këta shkrimtarë si: Buzukun, Budin, Bardhin e Bogdanin, në tërësinë e tyre nga distanca e kohës dhe nga gjendja e sotme e kulturës së atdheut tonë, vëmë re se ata përfaqësojnë një lulëzim të shënueshëm të shkrimit të gjuhës e të literaturës së vendit.

Rol të dorës së parë në historinë e gjuhës së shkruar shqipe kanë luajtur botimet e fjalës së shenjtë, sidomos i librave të meshës, nga të cilët themelorë për historinë e shqipes së shkruar mbetet *Meshari* i Gjon Buzukut (Shkurtaç 1999: 66).

Për ta gjuha u bë kodi i përbashkët. Për këtë profesor Eqrem Çabej theksonte: *“Këtu na del përpara një lloj koineje në shkrim, një gegërishte veriore e normalizuar. Edhe pse këta autorë, si njerëz të pajisur me kulturën e kohës, dinë të shquajnë në format krahinore nga format e përgjithshme dhe të nxjerrin pasojat e kësaj gjendjeje në shkrimet e tyre”* (Çabej 1975: 24).

Edhe pas Buzukut, Budit, Bardhit dhe Bogdanit gjuha shqipe mbeti një gjuhë jozyrtare, e shkruar mbi baza dialektore të gegënishtes (Shkurtaç & Gjinar 2003: 34). Tek të katërtë, shenjohej jo vetëm identiteti i tyre si kodifikues të rrënjëve identitare, po dhe si gjuhë-krijuese të këtij nacioni gjuhësor, historiko-gjeografik e kulturor.

Buzuku përdor alfabetin latin dhe me këtë alfabet do të shkruajnë edhe gjithë shkrimtarët vetiakë pas tij. Jo vetëm Buzuku, por edhe Budi, Bardhi e Bogdani edhe pse janë nga krahina të ndryshme, shohim se në shkrimet e tyre përdorin një shqipe të kuptueshme për të gjithë.

Fakti që këta nuk janë një e dy, po përbëjnë një varg burrash të pendës, na dëshmon se aty nuk kemi një dukuri kulturore sporadike, po kemi të bëjmë me një lëvizje mendore. Kjo gjë shënon një cak me rëndësi në historinë e popullit shqiptar (Xhiku, 2003: 24).

1. Fjalët e sajua

Çabej do përmbledhte mendimin e tij për gjuhën e Buzukut te *Meshari* si një gjuhë e rrjedhshme që e përshkon fund e majë atë dhe nga mënyra, me gjithë lëkundjet e shpeshta, mjaft konsekuente e shkrimit, arrin të bindet njeriu se në Shqipëri ka qenë formuar që më parë, së paku që në Mesjetën e vonë, një traditë letrare me shkrime liturgjike, me një ortografi gjer diku të stabilizuar (Çabej 1968: 25).

Përsa i takon leksikut të gjuhës popullore, bashkë me frazeologjinë e tij, do kujtuar se përkthimi nga latinishtja në shqip e nxori Buzukun para një sprove të fortë për të kërkuar fjalët e përshtatshme me frazeologjitë e tyre, pavarësisht nga ato, që do t'i ketë marrë prej shkrimeve shqipe të menduara se kanë qenë përpara tij e nga ato që në mënyrë vetjake i përftoi ose i zbërtheu në shprehje me përpjekjen e vet.

Duhet theksuar fakti se edhe para Buzukut të shkruarit e një gjuhe të kësaj cilësie, duke u barazuar te ligjërimi i popullit, do të ketë qenë në trashëgiminë e shkrimit shqip. Në lidhje me gjuhën e Buzukut Kolë Ashta, shkruan se gjuha e veprës së tij është një shqipe popullore që punohet nga shkrimtari. *Gjuha* e Buzukut, sipas Ashtës është: “*gjuhë e gjallë me format e veta fonetike, gramatikore, me rregullsi sintaksore, e ngritur në rangun e një gjuhe të lëvruar, e përpunoi, e stilizoi si mjet për të shkruar një vepër të gjërë*” (Ashta 2005: 403).

Në të shkruarit e shqipes popullore të bie në sy rregulli i Buzukut në ndërtimin e frazave e përdorimin e frazeologjive. Lënda gjuhësore, që përfshin fjalë, fraza e frazeologji, të cilat burojnë nga një gurrë e pashtershme, vjen e hyn në ndërtimin e frazave të Buzukut dhe merr cilësitë vetjake të shkrimtarit. Sigurisht në gjithë këtë vepër shquhet përpjekja vetjake e Buzukut për të shkruar një shqipe të punuar sipas frymës së gjuhës popullore dhe këtë përpjekje ta shohim po ashtu nga ana thjeshtë gjuhësore.

Përpjekja e parë ndër të tjerat u përket fjalëve të sajuara. Si shkrimtar, që e shkruan shqipen duke marrë pjesë vetë në të, herë-herë vepron në mënyrë origjinale sa që fjalinë e varur të tekstit e zëvendëson në përkthim me neologjizmin e vet: “*shprehjes ai që është lidhur*” Buzuku i thotë *burgëtar*, që do të thotë *i burgosur*; dalja e një neologjizmi qëndron në arsyen kur mungon fjala përkatëse prej nga rrjedhin.

Në të gjejmë edhe disa fjalë të tjera, si *bas-i* (krijuesi), *i pamort* (i pavdekshëm), *i pamasë*, *i pafryt*, *i parilenë*, të cilat mendohet se nuk janë të gjuhës së thjeshtë popullore, por ndoshta janë krijuar nga vetë autori. Nga ana gjuhësore në veprën e Buzukut një vend të rëndësishëm zënë edhe parafjalët. Nga ana leksikore gjuha e veprës së Buzukut, në përgjithësi, është e pastër, por ai përdor edhe latinizma, italianizma (si *nava*, *tentoj*, *fenestra*), sllavizma e pak turqizma (si *dollame*, *çohë*, *kallauz*).

Në këto rrethana nuk do të jemi gabim po të mendojmë që te libri i Buzukut kemi jo vetëm më të vjetrin monument të madh të gjuhës shqipe që

ne dimë, po përgjithësisht më të vjetrin monument të madh të kësaj gjuhe.

Vepra *Meshari* e Gjon Buzukut (1555), krijuar shekuj më parë, njohur e studiuar kryesisht në aspektin e problematikës gjuhësore dhe të përkthimit, përfaqëson një ndër ato vepra monumentale, që përbëjnë epokë në kulturën e një kombi (Dado 2006: 211). Të njëjtin mendim në lidhje me përkthimin ka edhe Prof. Çabej kur thekson se: “*me përjashtim të ndonjë fraze vetiake të autorit hedhur tek-tuk nëpër tekst, ky libër është fund e krye një përkthim*” (Çabej 1968: 25). Buzuku përktheu pjesë të liturgjisë, ndërkaq shqipen e shkroi nën një ndikim italo-roman, përkatësisht nën ndikimin venedikas.

Për gjuhën e *Mesharit* një konstatim me shumë vlerë e ka dhënë edhe prof. Eqrem Çabej, kur shprehet: “*Kjo gjuhë historikisht paraqitet si një gegërishte e shekullit 16, e cila i ka rrënjët në shqipen e mesjetës dhe si e tillë paraqet disa tipare paralele të shënueshme me dialektet shpeshherë konservative të toskërishtes jugore, e më anë tjetër me mbeturinat e toskërishtes mesjetare që ruhen edhe sot të gjalla në Greqi e në Itali*” (Çabej 2005:).

Për ta mbyllur këtë çështje me mendimin e **Selman Rizës**, i cili e vlerësoi veprën e Buzukut si një nga faqet më të ndritura të kulturës sonë kombëtare, them me plot gojën që, e përkrah shumë fort këtë ide të këtij studiuesi: vepra e Buzukut mbetet një monument nga të gjitha aspektet e studimit të saj.

2. Për ndihmë të gjuhës sonë

Duke ndjekur kronologjikisht historinë e shqipes së shkruar pas Buzukut, disa karakteristika të saj, në këtë periudhë, mund të nxirren duke vëzhguar edhe *gjuhën* e veprës së Pjetër Budit. Sikurse *gjuha* e Buzukut, edhe ajo e Budit është një gegërishte e mesme, shumë e afërt me toskërishten. Në strukturën fonetike hasim shpesh *ë-në* e patheksuar në fund të fjalës (*bukënë*, *faqesë*) dhe *ë-në* paratheksore e pastheksore (*dërejt*, *ishëmi*, *petëka*), diftongjet *ie* (*diell*) e *oe* (*voesë*), diftongun *uo* (*gruo*, *duo*), zanoret e gjata të dyfishuara (*dhee*, *trii*), grupet e

bashkëtingëlloreve **gl** e **kl**, që përdor Buzuku, janë palatalizuar në *q* e *gj*.

Është një fakt i rëndësishëm se tekstet e përkthyer përbëjnë një sektor kryesor të këmbimeve kulturore. *Doktrina e krishterë* e Budit është një përkthim i katekizmit të kardinalit Belarmino, veprë e përkthyer me kohë në shumë gjuhë të Europës. Të Budi gjejmë edhe disa zakone shqiptare të asaj kohe, nuk mungojnë edhe shkrimet origjinale.

Budi ishte marrë me përkthimin e hartimin e veprave fetare për nevoja të besimtarëve dhe për *“ndimet të patries e të gjuhës së sanë”*. Në pjesët që nuk janë përkthime Budi ka shtuar sqarime të cilat kanë të bëjnë me shtresat e ndryshme shoqërore të kohës.

Për të parë më mirë tekstin e Budit si tekst origjinal letrar e dëshmojnë edhe pikëpamjet e studiuesve që janë marrë me veprën e tij. Studiues si Mario Rok, Jokli, Mjeda, Çabej, Riza, Ashta, Camaj, Koliqi e Svane duke e ballafaquar tekstin e librave liturgjikë të Pjetër Budit me ato nga janë përkthyer janë të një mendjeje se veprat e tij në thelbin e tyre janë shumë më tepër se përkthim, sepse përmbajnë shumë ndryshime, përshtatje e shtojca.

Vlerë më vete veprimtarinë e Budit e bën, pa dyshim fakti se shkruante shqip vjersha me tematikë universale, që intelektuali i kohës mund t’i lexonte në gjuhë të tjera. Për origjinalitetin e tij, rëndësi të veçantë ka pikërisht qëndrimi i tij ndaj çështjes së gjuhës e të stilit, ku manifestohet vetja e tij, mbi të gjitha gjuha e pasur, e rrjedhshme dhe autentike (Ismajli 2000: 141).

Në këtë çast është i vlefshëm fakti që Budi na jep një përshkrim në veprën e tij poetike për të gjitha mëkatet, për *pendesën* dhe *ndëshkimin*, Budi atmosferën e *“Ditës së Gjyqit”* e jep kështu:

*“E një za i nalti si trumbetë,
fort i nalti të këmbojë,
këtë shekull të shkretë,
mbë gjithanet ta kërkojnë*

(Gjoka 2002: 17; Budi 1986: 51).

Leksiku është i pasur me fjalë e shprehje të gjuhës së folur të popullit (*s’kam as sy e faqe me i dalë përpara, thëngjilli i mbuluom, me shtimë laknë n’qafë*), por përmban edhe mjaft latinizma

e *italianizma*, ashtu siç i pamë pak më sipër të Buzuku. Në *leksikon* e veprës së Budit mungon elementi sllav, një dallim ky i cili tek Buzuku, zinte një vend modest. Ja, një tekst: *“e mbas gjithë këncu kafshësh desha ashtu ende me vuom këtu disa të tjera qi tashti banenë ndë këtë gjuhu tanë maa keq shëmtuom se as ndoonjë tjetër dorë gjindje përmbi dheet”* (*Ritualli roman 1621*; Samara 2000: 49 – 50).

Për historinë, sidomos të gjuhës letrare e të fjalorit të saj një rëndësi të veçantë ka leksiku i Budit. Te Budi, por edhe te të tjerët mund të ndiqet e të shihet se kur shfaqen për herë të parë fjalët që përbëjnë pasurinë e visarit leksikor kombëtar të shqipes, sidomos ato që përfaqësojnë fjalorin e sferës kulturore.

Kemi **leksema semantike**, fjalë që gjallojnë ende, si: *pleq, trima, perandor, zotëni, gra, vasha, mortja, begati, madhëshi, fjalë dialektore: vobeg, djelm, krye, petkat*. Bie në sy **vargu i sinonimeve**: *“me fjalë e me ligjërnuom, me lavdëruom e me perlëvduom”*. Te Budi dalin për herë të parë në shkrimin e shqipes fjalët: *i arsyeshëm, argëtuem, asgjamangu, përshëndet, sqimatar, shembëll, shkak, shkëlqenj*. Disa fjalë të shqipes së sotme të Budit janë përdorur me kuptim tjetër (p.sh. *lagje=palë, grup; parti*).

Vlerë tjetër e Budit është se ruajti origjinalin shkrimor dhe kjo vlerësohet si prurje e paçmuar për kulturën dhe letërsinë shqiptare. Figurshmëria e ngjeshur dhe emocionaliteti i dëshmuar, konfirmojnë vlera të qenësishme të ligjërimit poetik në krijimtarinë e Budit.

3. Shqetësimi për moslavrmin e gjuhës

Frang Bardhi me fjalorin e tij, *Latinisht- shqip*, nis traditën leksikografike shqiptare dhe të punëve me karakter gjuhësor ndër ne. Bardhi ka një vend të nderuar në historinë e gjuhësisë shqiptare.

Gjuha e veprës së *Frang Bardhit* nga Kallmeti, nga ana fonetike e gramatikore nuk dallohet shumë prej asaj të shkrimeve të autorëve të tjerë të kohës. Alfabeti është gati po ai. Në fushën e vokalizmit diftongu **uo** është kthyer në **ue**, ashtu siç është në gegërishtën letrare. Ja një tekst i transkriptuar: *“Gjithë atyne t’arbëneshëve qi ta marrënë me e zgjedhunë e me zanë. Tue pasunë*

ditë e përditë, të dashunitë e mi, mbasi hina ndë Kolegjë, kujtuem me qish çopë librë keshë me ndimuem mbë njaanë gjuhënë tanë, qi po bdaretë e po bastardhohetë saa maa parë të ve”.

Fjalori i tij latinisht- shqip me 5000 fjalë e 113 proverba, me rreth 250 faqe, shënon veprën e parë të leksikologjisë shqiptare. Ky fjalor ka rëndësi historike për gjuhën tonë letrare, sepse për herë të parë shqipja vihet përballë e në një rrafsh tërësor e të kodifikuar me leksikon e latinishtes.

Fjalori përbën një burim me vlerë për leksikologjinë historike të shqipes (Kastrati 2000: 79). Autorin e ka shqetësuar së tepërmi gjendja e gjuhës shqipe, sigurisht në lidhje me rrezikon që i vinte asaj nga të moslavruarit si mjet kulture.

Vepra e Bardhit është një dokument i gjallë i fjalës së shkruar shqipe të shek. XVII me vlerë shumë të madhe. Pasqyron, deri diku, gjendjen e leksikut të shqipes në shek. XVII me një nivel shkencor, që u përgjigjej kërkesave të leksikografisë së kohës.

4. Gërmimi i ‘fjalëve plaka’

Ideja e rrugës së veçantë që, ky popull, sipas Barletit, kishte formuar historikisht, qysh prej kohës antike, plotësohej me konceptin e kulturës si mjet formativ i shprehur qartë te Bogdani, sipas të cilit zhvillimi i gjuhës amtare ishte një faktor vendimtar për fatin e vendit e të popullit, për të mos e “*lanë dijen e gjuhën e dheut me u dvarun*”, për të cilën duhej luftuar “*porsi luftoi gjithë dheu e shekulli për të veten*”.

Bogdani ndryshe nga paraardhësit e tij, nga ana fonetike përdor me radhë zanoret e gjata e të dyfishuara, kurse nga ana gramatikore përdor shpesh habitoren (*adhuruekëshin*) në vend të së pakryerës (*adhuronin*), të kryerën e disa foljeve jokalmtare e formon me foljen ndihmëse jam (*anshtë dalë*) (Samara 2000: 53).

Duke e kundruar veprën në këndvështrimin **leksikologjik**, vëmë re rolin e madh që Bogdani i njej si gjuhës së folur, ashtu dhe gjuhës së shkruar. Rëndësia dhe ndihmesa e tij ishte në shumë fusha si: në fondin e termave që u përkasin **pedagogjisë** e **psikologjisë** ndeshemi me emërtime të tilla, si: *shkollë, shkollar, libër, xa*

(*mësoj*), *shembëlltyrë* (përfytyrim), *moshat: kërthinjëria, fëminjëria, djelmënia*. Siç dihet, mjaft nga termat e përdorura nga Bogdani mbetën pasuri e fondit të fjalorit të shkollës sonë. Në **fushën e astronomisë** gjithashtu nuk mungojnë termat përkatëse, si *Tokë, Qiell, yll, shenj, planet, Diell, Hënë, Mars, Mërkur, Venerë, Jov, Saturn, rruzullim, zodiak, meteor, kometë, eklips*. Bogdani na jep edhe emrat e disa vjësive. Sipas tij emrat e shenjave janë këto: *Dashi, Mëzati, Binoshi, (Binjakët), Gaforrja, Luani, Vajza, Terezia*. Bogdani i mori nga gjuha e folur e popullit, disa të tjera, si *zodiak, meteor* i huazoi nga fjalori i huaj.

Në fushën e historisë Bogdani përdori terma të tilla, si *rregj (mbret) i Arbënit, rregj i Austrisë, perëndia (sulltani) i Turqisë, shekull, pushtim, piramidë, luftë, kuvend, profet*.

Terminologjia në **fushën e gjeografisë**, po ashtu është e pasur. Shtrirja e saj rrok elemente të gjeografisë fizike, politike dhe të asaj ekonomike. Kështu shfrytëzohen terma si këta: *katër anët e horizontit që lidhen me erërat, rrethi i shekullit (Rrethi i Botës), dheu i Arbenit, dheu i magjypëve (Egjipti), mali i Sinaït, Lumë, lumi i Vardarit, i Danubit, i Nilit, i Tigris, deti i Kuq, liqen, qytet, sanxhak, malësor, banor, arbnesh, turk*.

Termit në fushën e **gjuhës** e të **letërsisë** përbëjnë një interes të veçantë. Të tilla janë për shembull: *gjuha, gjuha jonë, gjuha arbëneshe, gjuha e jonë, gjuha e dheut, gjuha ilirike, gjuha shqipe, fjalë, fjalë të gjalla, fjalë plaka, fjalë të harrueme, gramatikë, të folurit, vepër skalë* (Osmani 1996: 99).

Bogdanit një ndihmesë dhe vlerë e çmuar i ngelet edhe koncepti i **së bukurës**, të cilën e përshkruan në kuadër të **filozofisë** dhe **estetikës** së Mesjetës. E bukura kozmike si dhe njeriu është vepër e zotit.

Përveç të bukurës fizike Bogdani inkuadroi edhe të **bukurën metafizike**, d.m.th të bukurën shpirtërore, që ekziston në qenien njerëzore. Ajo është përfaqësim i botës së brendshme të shpirtit të njeriut, që e përshkon atë. Njëherësh kjo është e bukura e brendshme, e cila del si shpirtëzim i shpirtit të qenies.

Pjetër Bogdani pos përkthimeve që i sjell nga vargjet e *Psalmeve* të Biblës, në formë citati jashtë tërësisë së vargjeve, ai në mënyrë të veçantë sjell edhe disa pjesë, strofa nga poezitë e Homerit, Virgjilit, Juvenalit dhe Plinit. Edhe në këto përkthime është mjeshtër i mirë i përkthimit ku shihet aftësia e tij absorbuese e transponuese. Kështu dy heksametrat e Homerit i përktheu me tri vargje gjashtërokëshe në formë të gjuhës sonë e me rimë.

Ndërkaq, një strofë katërshe nga ekloga e katërt e Virgjilit e jep në shqip, po ashtu me të njëjtën strofë në vargun gjashtërokësh me rimë ABAB; nga Plini prej nëntë vargjeve katërmëdhjetërokëshe në latinisht i nxjerr në shqip dy strofa katërshe në varg gjashtërokësh popullor me rimë ABAB.

Edhe në këto përkthime shihet gjuha e tij e formuar poetike, liria kreative e përkthimit dhe kujdesi i madh për kuptimin e poezisë në gjuhën e përkthyer, që të jetë sa më shumë në frymën e asaj gjuhe, në mënyrë që të ushtrojë efektin e vet artistik e poetik.

Gjuha e veprës së *Pjetër Bogdanit* është mjaft e pasur dhe afron me gjuhën e Buzukut, Budit e Bardhit, por është më e rrjedhshme, elegante dhe e punuar. Ajo është karakteristike më shumë me të folmen e vendlindjes së autorit. Vepra e Bogdanit është shkruar në alfabetin latin, përmban një visar të madh leksikor shqip. Ai thotë se: *“mblodhi shumë fjalë plaka e të harrueme, që të mos dvarej gjuha”*.

Te Bogdani duhen pasur parasysh edhe dallimet dialektore të shqipes veriore të asaj kohe. Për arsyen e ditur se shkrimtari vërtet u nis nga baza dialektore verilindore e vendlindjes së tij, Guri i Hasit. Por ai bëri shumë përpjekje për t’ia përshtatur të folmen e tij malësore asaj qytetare shkodrane, siç është thënë me një metaforë duke larë teshat e veta në ujërat e kulluara të liqenit të Shkodrës (Omari 2005: 23).

Bogdani i dha një ndihmesë të rëndësishme zhvillimit të gjuhës shqipe. Si demiurg ideoi neologizma për fjalë a koncepte që nuk ekzistonin në shqip. Për përmbushjen e këtyre kërkesave ai gërmoi në thesarin e harruar të “fjalëve plaka” në zhdukje e sipër, ekliktoi

huazimet italiane për fjalë e koncepte që s’i kishte gjuha e tij. Kështu dëshmoi filozofinë e tij humaniste në pikënisjen e identitetit gjuhësor.

Konkluzione

Përmes analizës së leksikut të veprave të tyre vihet në pah se ata për hartimin, përshtatjen e përkthimin e librave liturgjikë kanë treguar një dashuri të veçantë për ngritjen e gjuhës krahinore e dialektore në nivel të një gjuhe letrare shqipe. Bëhen përpjekje të jepet një pasqyrë e përveçimit të përpjekjes së Gjon Buzukut për hartimin e një libri liturgjik me një gjuhë të pastërt shqipe të mbështetur në gjuhën popullore. Në të njëjtën vijë vazhdon Pjetër Budi, i cili shkon më tej se përkthimi e përshtatja e librave mësimorë liturgjikë dhe duke krijuar rreth 3200 vargje gjuhën shqipe e bëri gjuhë poetike. Për më tepër Frang Bardhi këtë udhëtim të shqipes të nisur nga pararendësit e çoi më tej. Ai do të angazhohet në një drejtim tjetër: me *Fjalorin e tij latinisht – shqip* e barazoi shqipen me latinishten, gjuhën e përgjithshme evropiane të kulturës së shkruar, letërsisë e shkencës në përgjithësi dhe të asaj kishtare në veçanti. Ndërkaq, Pjetër Bogdani, duke mos u kënaqur me këtë shkallë të lavrimit të shqipes, i hyri punës së hartimit të një libri enciklopedik liturgjik.

Bibliografia

- ASHTA, Kolë (2005), Gjon Buzuku e vepra e tij Meshari 1555: Buzuku dhe gjuha e tij, ASHSh, IGJL, Tiranë.
- BOGDANI, Pjetër (2005), Çeta e profetëve, Akademia e Shkencave, “MCM”, Tiranë.
- ÇABEJ, Eqrem (1975), Meshari i Gjon Buzukut (1555), pjesa e 1 dhe e 2-të, Tiranë.
- ÇABEJ, Eqrem (2005), Gjon Buzuku dhe gjuha e tij: Buzuku dhe gjuha e tij, ASHSh, IGJL, Tiranë.
- DADO, Floresha (2006), Intuitë dhe vetëdije kritike, Onufri, Tiranë.
- ELSIE, ROBERT (2001), Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Pejë.
- GJOKA, Behar (2002), Poetika e Budit, Albas, Tiranë-Tetovë.
- ISMAJLI, Rexhep (2000), Shkrime të vjetra, Dukagjini, Pejë.

KASTRATI, Jup (2000), Historia e Albanologjisë, Argeta-LMG, Tiranë.

MANSAKU, Seit (2005), Disa veçori morfosintaksore të librit të parë në gjuhën shqipe: Buzuku dhe gjuha e tij, ASHSh, IGJL, Tiranë.

NEZIRI, Zeqirja (2010), Epika gojore shqiptare, Shkup 2010.

NEZIRI, Zeqirja (1998), Historia e letërsisë shqiptare I, Shkup.

OMARI, Anila (2005), Pjetër Bogdani: Çeta e profetëve, ASHSh, Tiranë.

OSMANI, Shefik (2005), Pjetër Bogdani, IDROMENO, Tiranë.

SAMARA, Miço (2000), Histori e gjuhës letrare shqipe, SHBLU, Tiranë.

SHKURTAJ, Gjovalin & GJINARI, Jorgji (2003), Dialektologjia, SHBLU, Tiranë.

SHKURTAJ, Gjovalin (1999), Sociolinguistika, SHBLU, Tiranë.

SHUTERIQI, Dhimitër (2005), Tekste shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879 – 1800, ASHSH – IGJL, Tiranë.

TUFA, Agron (2009), Leksionet e lëndës së “Teorisë së Përkthimit”, Tiranë, prill- 2009, fl. 5-6.

XHIKU, Ali (2003), Duke lexuar letërsinë e traditës, Dituria, Tiranë